

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6771
E enjte, 1 dhjetor 2022
çmimi 0.40 €

Kuvendi miraton vendimin për dërgimin e FSK-së në mision jashtë vendit

FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

AMBASADORËT E BASHKIMIT EVROPIAN I THONË 'PO' LIBERALIZIMIT TË VIZAVE

FAQE 4-5

LËVIZJA PA VIZA PËR QYTETARËT E KOSOVËS, MË SË LARGU MË 1 JANAR 2024



Çështja e liberalizimit të vizave për Kosovën ka shkuar një hap më tutje. Ambasadorët e vendeve anëtare të BE-së u pajtuan të mërkurën për t'i dhënë mandat Këshillit Evropian që të negociojë për procesin e heqjes së vizave për Kosovën me Parlamentin Evropian. Sipas vendimit, lëvizja pa viza për qytetarët e Kosovës do të jetë e mundur kur të hyjë në fuqi sistemi evropian i udhëtimit, ETIAS, dhe data për këtë është 1 nëntori i vitit 2023. Por, në rast se do të ketë vonesa për këtë sistem, liberalizimi i vizave për Kosovën do të hyjë në fuqi jo më vonë se më 1 janar të vitit 2024

AKTUALE



OSMANI: SERBIA KA KRIJUAR
KRIZË QË TË MOS FLITET PËR
MARRËVESHJE FINALE

F. 3

ISH-KËSHILLTARI I THAÇIT:
PROKURORIA E SPECIALES ËSHTË
FURNIZUAR ME DEZINFORMATA
NGA SERBIA

F. 7

BISLIMI RAPORTON NË
KOMISIONIN PËR INTEGRIME
EVROPIANE PËR RAPORTIN
E KE-së PËR KOSOVËN

F. 5

EKONOMI



QEVERIA NDAN SHTATË MILIONË
EURO PËR PUNËTORËT E SEKTORIT
PUBLIK DHE STUDENTËT

F. 8

AGJENCIA FEDERALE E PUNËS:
GJERMANIA KA NEVOJË PËR MË
SHUMË PUNËTORË TË HUAJ

F. 8

SPORT



RIGA DRESHA, KARATEISTJA
QË PREMTON SHUMË

F. 10

OPOZITA, KURTIT: SITUATA NË VERI ËSHTË NJË KOLAPS SHTETËROR

FAQE 5



ÇFARË NËSE BOJKOTOHEN ZGJEDHJET NË VERI?

FAQE 6

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
+389 44 487 200
+389 44 487 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.PK.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Bideni u thotë liderëve të Kongresit se Ukraina dhe Covid-19 janë prioritetet kryesore

WASHINGTON, 30 NËNTOR - Presidenti amerikan Joe Biden ka theksuar se sigurimi i fondeve për Ukrainën dhe pandemia Covid-19 janë prioritetet e tij para se republikanët ta marrin kontrollin e Dhomës së Përfaqësuesve në fillim të vitit të ardhshëm. Bideni zhvilloi bisedime me liderët demokratë dhe republikanë të Dhomës së Përfaqësuesve dhe Senatit Amerikan lidhur me atë se çfarë mund të bëhet në javët që kanë mbetur para se republikanët ta marrin kontrollin e Dhomës. Aktualisht demokratët kanë kontrollin e dy dhomave të Kongresit Amerikan. Republikanët fituan shumicën në Dhomën e Përfaqësuesve në zgjedhjet e mesmandatit të mbajtura më 8 nëntor dhe do ta marrin kontrollin e kësaj dhome në janar. Marrja e kontrollit të Dhomës komplikon agjendën e Bidenit gjatë dy vjetëve të ardhshëm.

Në zgjedhjet e nëntorit demokratët e Bidenit arritën ta mbanin kontrollin e Senatit. Bideni tha se dhënia e ndihmës më të madhe ushtarake për Ukrainën është prioritet, por edhe financimi i masave për ta luftuar pandeminë e koronavirusit. Lideri i republikanëve në Dhomën e Përfaqësuesve, Kevin McCarthy, mori pjesë në takim me Bidenin. Ai u tha gazetarëve se do të ngrehë pyetje lidhur me financimin e Ukrainës, ndihmë që ka kaluar shifrën prej 18 miliardë dollarësh. Por, ai shtoi se është i gatshëm që të punojë me demokratët nëse ata "kanë vullnet që të vënë nën kontroll shpenzimet tona". Kryetarja e Dhomës së Përfaqësuesve, Nancy Pelosi, pas takimit u tha gazetarëve se demokratët ndoshta duhet ta miratojnë planin e shpenzimeve të qeverisë më 30 shtator. Kjo do të mundësonte që republikanët



të mos kenë mundësi të bëjnë shkurtime në buxhet. Bideni, po ashtu, tha se financimi i qeverisë përtej 16 dhjetorit, për

ta shmangur mbylljen, është lart në agjendën e tij. Përveç McCarthyt dhe Pelosit, në takimin me Bidenin ishin të

pranishëm edhe lideri i Senatit, Chuck Schumer dhe lideri republikan në Senat, Mitch McConnell.

Brukseli propozon planin për konfiskim të aseteve të ngrira ruse



Bruksel, 30 nëntor - Komisioni Evropian ka propozuar të mërkurën një plan për t'i konfiskuar asetet ruse që janë ngrirë si pasojë e sanksioneve për ndëshkim të Moskës, pas luftës së nisur në Ukrainë, në fund të muajit shkurt. "Ne kemi bllokuar 300 miliardë euro të rezervave të Bankës Qendrore të Ruisë dhe kemi bllokuar 19 miliardë euro të oligarkëve rusë", ka thënë presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, përmes një deklarate. Ajo ka thënë se BE-ja mund t'i menaxhojë paratë në periudhë afatshkurtër dhe më pas t'i investojë ato. Plani parasheh që paratë të mund të ndahen për Ukrainën si kompensim për dëmet që i janë shkaktuar nga lufta. "Ne do të punojmë me partnerët tanë në një

marrëveshje ndërkombëtare, që ta bëjmë të mundur këtë gjë. Së bashku ne do të tentojmë të gjejmë rrugë ligjore", ka thënë von der Leyen. Ajo ka thënë, po ashtu, se BE-ja është duke propozuar krijimin e një gjykate speciale, të mbështetur nga Kombet e Bashkuara, "për të hetuar dhe gjykuar krimet e kryera nga Rusia". Lufta në Ukrainë ka nisur më 24 shkurt. Presidenti rus Vladimir Putin e konsideron luftën "operacion special ushtarak" për ta çmilitarizuar Ukrainën. Perëndimi është përgjigjur ndaj Ruisë, duke goditur ekonominë e këtij shteti me sanksione të ashpra. Si pasojë e luftës kanë vdekur mijëra persona dhe miliona të tjerë janë zhvendosur nga shtëpitë e tyre.

Vdes ish-lideri kinez Jiang Zemin

PEKIN, 30 NËNTOR - Ish-presidenti kinez Jiang Zemin ka vdekur të mërkurën në moshën 96-vjeçare nga leukemia dhe dështimi i shumëfishtë i organeve, ka raportuar të mërkurën media shtetërore. Jiang ka vdekur në shtëpinë e tij në Shanghai, ka njoftuar agjencia e lajmeve "Xinhua", duke publikuar një letër të autoriteteve shtetërore përmes së cilës është bërë e

ditur vdekja. "Vdekja e Jiang Zemit është një humbje tejet e madhe për partinë tonë, ushtrinë dhe popullsinë tonë të të gjitha etnive", është thënë në letër, duke njoftuar se vendimi është bërë me "dhimbje të madhe". Në letër Jiang është përshkruar si lider i jashtëzakonshëm, një marksist i mrekullueshëm, lider shtetëror, strateg ushtarak, diplomat dhe luftëtar komunist i dëshmuar për kohë

të gjatë. Jiang ka fituar pushtetin pas shtypjes së përgjakshme të protestave pro-demokracisë që janë mbajtur më 1989 në sheshin Tiananmen. Megjithatë, ai më vonë ka arritur ta nxjerrë vendin nga një izolim i atëhershëm diplomatik dhe t'i rregullojë marrëdhëniet me Shtetet e Bashkuara. Pas zbatimit të këtyre politikave, Kina ka përjetuar bum ekonomik.



Osmani: Serbia ka krijuar krizë që të mos flitet për marrëveshje finale

SOFJE, 30 NËNTOR - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka thënë të mërkurën se Serbia ka krijuar krizë në javët e fundit në mënyrë që të mos diskutohet marrëveshja finale në mes të Kosovës dhe Serbisë. Ajo i ka bërë këto deklarata në një konferencë të përbashkët për medie me presidentin bullgar Ruman Radev në Sofje. “Është koha që ndërmjetësuesi i dialogut, Bashkimi Evropian, ta kuptojë se Serbia ka përdorur taktikën e pengimit përmes pjesëmarrjes”, është shprehur ajo. Sipas Osmanit, pala serbe diskuton në tavolinë me kushtëzime dhe pengesa. “Kjo është mënyra se si ata tentojnë ta bllokojnë perspektivën e Kosovës në rajon dhe në nivel ndërkombëtar. Natyrisht, është në interesin tonë ta përmbyllim këtë dialog me një marrëveshje ligjërish të zbatueshme dhe duhet ta kuptojmë se pala që është në anën tjetër të tavolinës, nuk është e interesuar ta përmbyllë këtë proces me sukses”, ka deklaruar Osmani.

Presidentja e Kosovës ka thënë se Serbia ka nisur të prodhojë kriza



muaj më parë kur, sipas saj, Bashkimi Evropian, i mbështetur nga Shtetet e Bashkuara, Franca dhe Gjermania, ka dalë me një propozim për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve mes dy vendeve.

Propozimi që përmendi ajo, i njohur në publik si plani franko-gjerman, thuhet se parasheh disa

hapa që do të çonin në zgjidhjen e problemeve midis Prishtinës dhe Beogradit.

Së voni Bashkimi Evropian ka nisur t'i referohet atij si “propozimi i Brukselit”.

“Interesi ynë është i kundërt, pra që diskutimet të nisin sa më parë që është e mundur”, ka thënë Osmani, duke shtuar se shpreson

që BE-ja t'i dërgojë mesazh Serbisë se nuk mund ta bllokojë më procesin.

Ekzistenca e propozimit të BE-së është konfirmuar edhe nga liderët e Kosovës, edhe nga ata të Serbisë. Në Kosovë është parë si “bazë e mirë” për diskutime të mëtejme në kuadër të dialogut për normalizimin e marrëdhënieve

me Serbinë, që ndërmjetësohet nga BE-ja, ndërsa në Serbi kanë thënë se ky plan nuk është në favor të saj.

Më herët, presidenti serb Aleksandër Vuçiq ka deklaruar se plani parasheh që Serbia të mos e pengojë Kosovën për anëtarësim në organizata ndërkombëtare, përfshirë Kombet e Bashkuara, në këmbim të përsheptimit të anëtarësimit të saj në BE. “Është koha që Serbia përfundimisht të vendosë se në cilin drejtim dëshiron të shkojë. Në drejtim kah Evropa, apo në drejtimin e Moskës? Nuk mund të jesh me të dyja palët”, ka thënë Osmani.

Tensionet në mes të Kosovës dhe Serbisë kanë qenë të larta qysh në verë për shkak të një vendimi të Qeverisë së Kosovës për reregjistrimin e makinave me targa serbe në RKS - Republika e Kosovës. Në muajin nëntor dy vendet kanë arritur marrëveshje për targa nën ndërmjetësim të Bashkimit Evropian. Marrëveshja parasheh që Kosova ta pezullojë planin për reregjistrim të makinave dhe që Serbia të mos lëshojë më targa serbe për qytetarët në Kosovë.

Kuvendi miraton vendimin për dërgimin e FSK-së në mision jashtë vendit



**EPOKA
ERE** **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 30 NËNTOR - Një ditë më parë Qeveria e Kosovës ka miratuar vendimin për dërgimin e një kontingjenti të Forcës së Sigurisë së Kosovës në mision paqeruajtës në Ishujt Falklands. Në mbledhjen e mbajtur në mënyrë elektronike, qeveria ka njoftuar se ky vendim do t'i dërgohet për miratim Kuvendit të Kosovës, në mënyrë që pjesëtarët

e FSK-së të marrin pjesë në këtë mision.

Deputetët të mërkurën e miratuan këtë vendim, që është misioni i dytë jashtë vendit i pjesëtarëve të FSK-së. “Misioni i FSK-së do të jetë në mbështetje të paqes në Ishujt Falklands dhe gjatë këtij misioni do t'i nënshtrohet marrëveshjes së nënshkruar me Mbretërinë e Bashkuar. Në këtë mision do të dërgohen deri në 7 pjesëtarë të FSK-së dhe ky mision mund të

zgjaset deri në tre vjet, me mundësi vazhdimi”, u tha në njoftimin e ekzekutivit.

Misioni i FSK-së do të mbulohet financiarisht nga buxheti i Kosovës, ndërkaq pjesëtarët e saj do të jenë nën komandën e forcave të armatosura të shtetit pritës.

Kosova dhe Mbretëria e Bashkuar në shtator të vitit 2022 nënshkruan marrëveshjen për bashkë-zbarkime të forcave të tyre në misione ushtarake jashtë

këtyre dy shteteve.

Atëbotë zyrtarët e Kosovës thanë se nënshkrimi i marrëveshjes “rikonfirmon fuqishëm besueshmërinë e plotë të Mbretërisë së Bashkuar dhe qeverisë së saj në Ministrinë tonë të Mbrojtjes dhe kapacitetet e forcave tona”.

Kosova ka marrëveshje me Shtetet e Bashkuara për angazhim të përbashkët të forcave ushtarake në misione të ndryshme.

Përmes këtij bashkëpunimi me trupat amerikane, më 2021 një kontingjent i FSK-së u dërgua në Kuvajt - në misionin e parë jashtë vendit.

FSK-ja numëron afër 2 500 trupa të rregullt dhe 800 rezervistë. Numri i forcave të saj të rregullta pritet të dyfishohet kur të mbarojë procesi i transformimit. Forca e Sigurisë së Kosovës ka nisur procesin e transformimit të plotë në ushtri më 2018. Ky proces pritet të zgjasë dhjetë vjet.



AMBASADORËT E BASHKIMIT EVROPIAN I THONË 'PO' LIBERALIZIMIT TË VIZAVE

Lëvizja pa viza për qytetarët e Kosovës, më së largu më 1 janar 2024

Çështja e liberalizimit të vizave për Kosovën ka shkuar një hap më tutje. Ambasadorët e vendeve anëtare të BE-së u pajtuan të mërkurën për t'i dhënë mandat Këshillit Evropian që të negociojë për procesin e heqjes së vizave për Kosovën me Parlamentin Evropian. Sipas vendimit, lëvizja pa viza për qytetarët e Kosovës do të jetë e mundur kur të hyjë në fuqi sistemi evropian i udhëtimit, ETIAS, dhe data për këtë është 1 nëntori i vitit 2023. Por, në rast se do të ketë vonesa për këtë sistem, liberalizimi i vizave për Kosovën do të hyjë në fuqi jo më vonë se më 1 janar të vitit 2024.

**EPOKA
ERE**

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 30 NËNTOR - Ambasadorët e vendeve anëtare të Bashkimit Evropian janë pajtuar të mërkurën për t'i dhënë mandat Këshillit Evropian që të negociojë për procesin e liberalizimit të vizave për Kosovën me Parlamentin Evropian. Sipas vendimit, lëvizja pa viza për qytetarët e Kosovës do të jetë e mundur kur të hyjë në fuqi sistemi evropian i udhëtimit, ETIAS, dhe data për këtë është 1 nëntori i vitit 2023. Por, në rast se do të ketë vonesa për këtë sistem, liberalizimi i vizave për Kosovën do të hyjë në fuqi jo më vonë se më 1 janar të vitit 2024. "Sot ne kemi marrë një hap të rëndësishëm për Kosovën drejt lëvizjes së lirë pa viza. Shpresojmë të arrijmë një marrëveshje me Parlamentin Evropian për ta bërë këtë premtim realitet. Liberalizimi i vizave është bërë i mundur falë përpjekjeve të

Kosovës për ta forcuar kontrollin kufitar dhe për ta menaxhuar migrimin. Besojmë se ky bashkëpunim i mirë vetëm sa do të forcohet në të ardhmen", ka thënë ministri i Jashtëm çek Jan Lipavsky. Vendi i tij udhëheq presidencën e bllokut evropian dhe ka përpiluar tekstin e vendimit që është miratuar nga ambasadorët e BE-së. Sipas vendimit, liberalizimi i vizave do të vlejë vetëm për bartësit e pasaportave biometrike në përputhje me standardet ndërkombëtare të udhëtimit. "Pa paragjykuar qëndrimet e vendeve anëtare ndaj statusit të Kosovës - në periudhën deri te nisja efektive e liberalizimit të vizave dhe ku do të jetë i zbatueshëm vendimi - Kosova duhet të synojë të arrijë marrëveshje apo aranzhime për riatdhesim me ato vende të BE-së me të cilat nuk i ka". Diçka e tillë kërkohet për t'iu mundësuar vendeve anëtare të BE-së që të mund t'i dëbojnë nga

territori i tyre qytetarët e Kosovës në rast se ata keqpërdorin liberalizimin e vizave duke qëndruar ilegalisht, apo nëse kërkojnë azil pa pasur bazë. Kosovës, po ashtu, i kërkohet të vazhdojë ta përshtatë politikën e saj të vizave me atë të BE-së, ndërkohë që i mbetet të kalojë edhe nëpër disa procedura të tjera që i kërkojnë vendet anëtare.

Pse lidhet procesi i vizave me sistemin ETIAS?

ETIAS kërkon që qytetarët e huaj, të cilët udhëtojnë pa viza në territorin e BE-së, t'i regjistrojnë të dhënat e tyre në këtë sistem para udhëtimit. Franca ka qenë shteti që ka këmbëngulur më së shumti që hyrja në fuqi e liberalizimit të vizave për Kosovën të lidhet me funksionalizimin e ETIAS-it, duke thënë se ai është i rëndësishëm për rritjen e sigurisë së vendeve

anëtare.

Liberalizimi i vizave do t'u mundësojë qytetarëve të Kosovës të udhëtojnë lirshëm në atë që njihet si zona Schengen e që përbëhet prej 26 shtetesh evropiane.

Kosova aktualisht është vendi i vetëm në Ballkanin Perëndimor, qytetarët e të cilit nuk mund të lëvizin lirshëm në këtë zonë. Kjo, përkundër faktit se Komisioni Evropian, qysh në vitin 2018, ka konfirmuar disa herë se Kosova i ka përmbushur të gjitha kushtet për liberalizimin e vizave, por kanë qenë disa vende anëtare që vazhdimisht kanë shprehur rezervë.

Pas këtij vendimi reagime të shumta kanë "vërshuar" në "Twitter" nga personalitete të ndryshme ndërkombëtare. Thomas Waitz, deputet në Parlamentin Evropian, e ka quajtur lajm të mirë vendimin për negociimin e procesit për heqjen e vizave për Kosovën. "Më në fund këshilli ka rënë dakord që të fillojë negociatat për liberalizimin e vizave për Kosovën. Ky është vërtet një lajm i madh! Shpresojmë se do të ndodhë pa asnjë vonesë", ka shkruar Waitz. Vendimin e ambasadorëve të BE-së për vizat e ka mirëpritur edhe gazetari për çështje evropiane dhe

të NATO-s, Stephan Israel. "U rregullua para përfundimit të këtij viti. Faleminderit Presidencës Çeke! Pas kësaj Spanja dhe Suedia do ta marrin përsipër, me pak interesim për avancimin e dosjes", ka shkruar Israel.

Jack Parrock, korrespondent nga BE-ja, ka thënë se vizat do të hyjnë në fuqi ndoshta në janar të 2024-s. "Vendet e BE-së kanë dhënë miratimin e tyre për fillimin e negociatave për liberalizimin e vizave për Kosovën. Ambasadorët dhanë pëlqimin këtë mëngjes me diskutimet që do të nisnin seriozisht përpara Vitit të Ri. Periudha më e hershme kur do të hynin në fuqi rregullat e vizave, ndoshta do të jetë janari i vitit 2024", ka shkruar Parrock.

Zëdhënësja e Presidencës Çeke, Eva Hrnčirova, ka shkruar se shpreson që procesi të vazhdojë pa probleme. "Më në fund një lajm i mirë për Kosovën. Shpresoj që të vazhdojë pa probleme", ka shkruar Hrnčirova.

Ndërkaq diplomati austriak Andreas Sumper e ka quajtur lajm të shkëlqyer vendimin për vizat për qytetarët e Kosovës. "Lajm i shkëlqyer. Liberalizimi i vizave për Kosovën është në rrugë të mbarë. Hap i rëndësishëm është marrë sot në kuadër të Presidencës Çeke", ka shkruar Sumper.

Bislimi raporton në Komisionin për Integritime Evropiane për raportin e KE-së për Kosovën



PRISHINË, 30 NËNTOR - Komisioni për Integritime Evropiane, kryesuar nga kryetarja Rrezarta Krasniqi, ka mbajtur mbledhjen e radhës, në të cilën ka raportuar Besnik Bislimi, zëvendëskryeministër i parë për Integritim Evropian, Zhvillim dhe Dialog në Qeverinë e Republikës së Kosovës.

Paraqitja e kryeministrit Bislimi në këtë komisioni kishte të bënte me raportin

e KE-së për Kosovën, përkatësisht të arriturat, ngecjet dhe rekomandimet për përmbushjen e agjendës së integritimeve evropiane. Sa i përket raportit, Bislimi vlerësoi se ai është ndër më të mirët e gjertanishëm dedikuar vendit tonë.

Duke folur për të arriturat, të cilat raporti i përmban, zëvendëskryeministër Bislimi vuri në spikamë stabilitetin politik dhe

institucional të vendit.

Në vijim ai u fokusua në të arriturat që i përkasin fushës legislative, duke listuar me këtë rast një varg ligjesh të miratuara, përfshirë këtu edhe Rregulloren e Punës së Kuvendit.

Gjatë ekspozesë së paraqitur nga zëvendëskryeministër Bislimi, me rëndësi u cilësuan edhe disa nga vendimet qeveritare, të përfshira po ashtu në raport. "Vendimi që disa nga

terminalet doganore të kalojnë nga private në publike, si dhe vlerësimi se nuk ka pasur ndërhyrje në gjyqësor e as në punësim janë të arriturat të cilat nuk i përmbanin raportet e mëhershme", ka deklaruar Bislimi. Pas kësaj u zhvillua debat, gjatë të cilit përfaqësuesit opozitarë në komision dhanë kritika, se zëvendëskryeministër Bislimi nuk është duke e paraqitur raportin në

përbërje të plotë, por vetëm aspekte pozitive, duke lënë anash kritikën dhe rekomandimet.

Liria e medieve, jotransparenca qeveritare, sidomos lidhur me dialogun, ishin vetëm disa nga kritikën që opozita ngriti me këtë rast. Po ashtu, përfaqësuesit opozitarë vlerësuan se për të arriturat e theksuara në raport, meritore është edhe opozita.

Haxhiu: Jam dhe do të vazhdoj të jem zë në kauzën kundër dhunës ndaj grave dhe vajzave



PRISHINË, 30 NËNTOR - Ministria e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, ka vlerësuar rolin dhe përkushtimin e shoqërisë civile, partnerëve vendorë dhe ndërkombëtarë në kauzën e përbashkët për trajtimin e rasteve të dhunës.

Në një fjalë rasti në tryezën me temë "Dhuna ndaj vajzave - drejt parandalimit dhe reagimit efektiv", organizuar nga koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve - KOMF,

UNICEF dhe UN Women, ministria Haxhiu tha se përbashkimi në këtë kauzë të drejtë dhe të domosdoshme na bënë më të fortë, të pandalshëm dhe të suksesshëm në betejën kundër dhunës me bazë gjinore. "Si ministere e Drejtësisë, që nga pranimiti i këtij mandati, jam dhe do të vazhdoj të jem bashkë me të gjithë ata zëra që angazhohen për përmirësimin e kësaj situatë. Jam e vetëdijshme që pozita në institucionin të cilën e

drejtoj më jep edhe më shumë mundësi edhe më shumë kompetencë që të orientoj politikën përmes nismave ligjore në këtë drejtim. Jam bashkë me ju edhe në thirrjet e tjera ndaj institucioneve si policia, gjykata e prokuroria, të cilat duhet të zgjohen. Misioni i vetëm i tyre është të veprojnë. Të veprojnë në bazë të ligjit dhe kompetencave që kanë", ka theksuar ministria e Drejtësisë.

Haxhiu ka thënë se me përkushtimin aktiv të shoqërisë civile dhe sot me institucionet e republikës është rritur angazhimi për ngritjen dhe ndërgjegjësimin e qytetarëve dhe të institucioneve, që të kenë vëmendjen e merituar ndaj dhunës si fenomen, ndaj vajzave dhe grave, ndaj viktimave dhe të ketë drejtësi për ato. Në këtë tryezë ministria Haxhiu thase për herë të parë Ministria e Drejtësisë ka marrë përsipër organizimin e

fushatës globale "16 Ditët e Aktivizmit Kundër Dhunës me Bazë Gjinore", pas një partneriteti të mirëfilltë me organizatat e shoqërisë civile drejt angazhimit institucional në këtë drejtim, për ta treguar edhe seriozitetin tonë qytetar e institucional edhe ndaj institucioneve të tjera që nuk po veprojnë sa duhet e siç duhet, sikurse edhe ndaj personave të papërgjegjshëm dhunues.

Çka nëse bojkotohen zgjedhjet në veri?

PRISHTINË, 30 NËNTOR - Zgjedhjet për kryetarë të katër komunave në veri të Kosovës mund të nxjerrin probleme politike dhe jologjore nëse pjesëmarrja në to bojkotohet, ashtu siç është paralajmëruar, thonë njohës të çështjeve zgjedhore dhe të administrimit të pushtetit lokal. Këto probleme, sipas tyre, mund të kenë pastaj pasoja në funksionalizimin e institucioneve të vetëqeverisjes lokale.

Zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetarë të katër komunave me shumicë serbe - Mitrovicë e Veriut, Zubin Potok, Leposaviq dhe Zvečan - do të mbahen më 18 dhjetor. Kryetarët e këtyre komunave kanë dhënë dorëheqje në fillim të nëntorit, duke kundërshtuar një vendim të Qeverisë së Kosovës për reregjistrimin e makinave në veri, që bartin targa të paligjshme serbe.

Të katërtit kanë ardhur nga Lista Serbe - subjekti më i madh politik i serbëve në Kosovë. Kjo parti, e cila kontrollohet nga Beogradi zyrtar, refuzon të marrë pjesë në zgjedhjet e muajit të ardhshëm.

Përfaqësues të saj, po ashtu, kanë thënë se "95 për qind e votuesve" të kësaj partie, nuk do të dalin në votime.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në Kosovë ka njoftuar më 28 nëntor se ka certifikuar 12 kandidatë nga gjashtë subjekte politike, të cilat do të garojnë në zgjedhjet në veri.

Ata vijnë nga: Lëvizja Vetëvendosje (LVV), Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Iniciativa Qytetare Mitrovica, Partia e Serbëve të Kosovës, Iniciativa Qytetare Mbijetesa Serbe dhe një kandidatë është e pavarur.

Qytetarët e anketuar serbë: "Nuk do të dalim në zgjedhje"

Disa qytetarë që jetojnë në komunat në veri të Kosovës, e me të cilët ka biseduar Radio Evropa e Lirë, thonë se nuk do të dalin në votime në zgjedhjet e 18 dhjetorit. Radovan Millković thotë se e ka marrë këtë vendim pavarësisht prej faktit se disa subjekte politike



serbe i kanë kandidatët e tyre në garë. "Kjo për shkak se tek ata nuk i shohim përfaqësuesit e popullit tonë në Kosovë", thotë Millković. Me mospjesëmarrjen e Listës Serbe kjo garë nuk i ka njerëzit e duhur, thotë Predrag Radovanović. Për të kandidatët e partive serbe që marrin pjesë në zgjedhje janë "të panjohur". "Këta njerëz nuk janë të qartë për mua. Mendoj për ata që tash duan të kandidojnë për të arritur në pushtet, ndërsa e dinë se nuk kanë pasur kurrfarë mbështetjeje nga njerëzit, nga unë personalisht dhe as nga miqtë e mi në veri të Kosovës", thotë Radovanović.

A kanë legjitimitet zgjedhjet nëse bojkotohet pjesëmarrja?

Ish-kryetarja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Valdete Daka, thotë se Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë nuk parashihet ndonjë prag të pjesëmarrjes së qytetarëve në zgjedhje. Kjo, sipas saj, vlen edhe në rastin e zgjedhjeve të jashtëzakonshme për kryetarët e katër komunave në veri të Kosovës. "Ato [zgjedhjet] do të jenë legale. Mirëpo, se sa do të jenë rezultatet e pranueshme, kjo është çështje tjetër, të cilën nuk mund ta rregullojë ligji". "Kjo është çështje që do të varet prej partive që janë atje, konkretisht nga Lista Serbe. Kjo parti, me vetë faktin që po i

thërret qytetarët që të mos dalin në votime, po tregon se nuk i pranon këto zgjedhje. Ky është problem politik që nuk mund të zgjidhet me zgjedhje", thotë Daka për "Radion Evropa e Lirë". Nëse kandidatët fitojnë mandatin me pjesëmarrje të ulët të votuesve, shton Daka, legjitimiteti i përfaqësimit të tyre mund të vihet në dyshim. "Ai apo ajo e përfaqëson një numër të vogël të qytetarëve që kanë votuar. Se sa ka legjitimitet që t'i përfaqësojë të gjithë qytetarët e asaj komune, më pas është çështje për diskutim", thotë Daka.

Problemet si pasojë e bojkotit të mundshëm të zgjedhjeve

Sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, kryetari i komunës ka një varg përgjegjësish ndaj ekzekutivit, administratës, por edhe kuvendit komunal. Ish-ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal, Sadri Ferati, thotë se mospjesëmarrja eventuale e qytetarëve serbë në zgjedhjet e 18 dhjetorit, pavarësisht se nuk mund ta kontestojë ligjshmërinë e procesit, mund të prodhojë probleme në funksionalizimin e institucioneve të vetëqeverisjes lokale. "Nëse do të ketë bojkot pothuajse të plotë nga komuniteti serb, atëherë nuk do të prodhohet ndonjë kualitet dhe nuk do të prodhohen struktura që do të

mund ta normalizojnë funksionimin e këtyre institucioneve". "Në anën tjetër, në rast se instalohet një strukturë, pra një kryetar joserb, atje do të pasojë bojkoti që administrata mund t'ia bëjë atij kryetari. Mendoj se prapë do ta kemi një situatë jo të rregullt", thotë Ferati për Radion Evropa e Lirë.

Ai shton se në rast se qytetarët serbë i bojkotojnë zgjedhjet, atëherë ata mund t'i bojkotojnë edhe institucionet komunale - pavarësisht se rezultati i zgjedhjeve do të jetë i ligjshëm. "Nëse qytetarët fillojnë ta bojkotojnë atë institucion dhe, në anën tjetër, administrata që është përbrenda [komunës] i nënshtrohet presionit për t'i shërbyer stafit politik, pra kryetarit, ne mund të ballafaqohemi me situata... që [mund] të numërohen se cila është më e keqe", thotë Ferati. Për dallim nga kryetarët e komunave të tjera të Kosovës, katër kryetarët e komunave në veri propozojnë te Qeveria e Kosovës edhe komandantin e Policisë së Kosovës për rajonin e veriut, i cili më pas emërohet nga Ministria e Brendshme e Kosovës. Kjo kompetencë u është dhënë me një marrëveshje që kanë arritur Kosova dhe Serbia në vitin 2013 në kuadër të dialogut për normalizimin e marrëdhënieve. Në fillim të nëntorit drejtori i Policisë së Kosovës për rajonin e veriut, Nenad Gjuriq, është

suspenduar pasi ka refuzuar ta zbatojë vendimin e Qeverisë së Kosovës për reregjistrimin e makinave me targa serbe.

Në shenjë pakënaqësie me këtë vendim, dorëheqje - përveç kryetarëve të komunave në veri - kanë dhënë edhe zyrtarë të tjerë serbë nga veriu si nga niveli lokal ashtu edhe ai qendror.

Serbia e ka mbështetur largimin e tyre nga institucionet e Kosovës dhe është zotuar se do t'ua kompensojë rrogat që kanë marrë nga institucionet e Kosovës.

Nuk është e qartë nëse ata do të mund të kthehen në punë dhe, nëse po, si?!

Për çështjen e targave, ndërkohë, Kosova dhe Serbia kanë arritur një marrëveshje, në bazë të së cilës Prishtina pezullon zbatimin e planit të saj për reregjistrimin e makinave, ndërsa Beogradi ndalon lëshimin e targave të reja për serbët në veri.

Kandidatët për kryetar të komunave në veri të Kosovës

Për kryetar të komunës së Mitrovicës së Veriut do të garojnë: Betim Osmani nga Iniciativa Qytetare Mitrovica, Taulant Kelmendi nga PDK-ja, Erden Atiq nga LVV-ja dhe Aleksandër Arsenijević nga Iniciativa Qytetare Mbijetesa Serbe. Për kryetar të komunës së Lesapoviqit do të garojnë: Albulena Behluli - Hetemi nga PDK-ja, Lulzim Hetemi nga LV-ja dhe Aleksandar Jabllanović nga Partia e Serbëve të Kosovës. Për kryetar të komunës së Zvečanit do të garojnë: Ilir Peci nga PDK-ja, Fetah Peci nga LV-ja dhe kandidatja e pavarur Sllagjana Pantović. Për kryetar të komunës së Zubin Potokut do të garojnë: Izmir Zeqiri nga PDK-ja dhe Flatron Hasani nga LV-ja. Në këtë komunë nuk ka kandidatë nga partitë serbe.

Apeli vërteton dënimin me 3 vjet e 6 muaj burgim ndaj Gani Gecit për vrasjen e Ruzhdi Shaqirit

Prishtinë, 30 nëntor - Gjykata e Apelit ka vërtetuar dënimin me 3 vjet e 6 muaj burgim për ish-deputetin e Kuvendit të Kosovës, Gani Geci, i akuzuar për vrasjen e Ruzhdi Shaqirit në gusht të vitit 2014.

Sipas aktgjykimit të shpallur më 4 qershor 2021, nga Gjykata Themelore në Mitrovicë, Geci u dënua me 3 vjet burgim për

vrasje të kryer në gjendje të tronditjes së fortë mendore, kurse me 10 muaj burgim për armëmbajtje pa leje. Ndaj tij u shqiptua dënimi unik prej 3 vjet e 6 muaj burgim efektiv.

Kundër këtij aktgjykimi ankesë në Gjykatën e Apelit kishin parashtruar Prokuroria Themelore në Mitrovicë, përfaqësuesi i palës së dëmtuar,

Sokol Dobruna dhe i akuzuari Gani Geci me avokatin e tij Ndrec Dodaj.

Prokuroria Themelore në Mitrovicë kishte propozuar që lënda të kthehet në rigjykim ose të ndryshohet sa i përket pikës 1, në anën tjetër i akuzuari Geci dhe avokati i tij, Dodaj, kanë propozuar që Geci të lirohet nga vepra penale e vrasjes.



Opozita, Kurtit: Situata në veri është një kolaps shtetëror

EPOKA
ERE

Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 30 NËNTOR - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka komentuar të mërkurën dorëheqjet e serbëve nga institucionet e Kosovës, duke thënë se vakumet duhen mbushur me "aplikime të reja për punë".

Qindra serbë të Kosovës nga katër komunat veriore të vendit që nga fillimi i nëntorit kanë dhënë dorëheqje nga disa institucione të Kosovës, përfshirë policinë, gjyqësorin, si dhe në nivel politik në komuna dhe në Kuvendin e Kosovës.

Dorëheqjet u bënë në shenjë kundërshtimi ndaj vendimit të Qeverisë së Kosovës që kërkonte reregjistrimin e targave të veturave që lëshohen nga Serbia me akronime të qyteteve të Kosovës në RKS.

Kryeministri Kurti, i thirrur në një interpelancë në Kuvendin e Kosovës, i quajti dorëheqjet vendime politike. Duke folur specifikisht për dorëheqjet e 578 zyrtarëve policorë që vijnë nga komuniteti serb në Kosovë, ai tha se dorëheqjet janë bërë "për arsye të paqena". "Thoshin morale e individuale e teksti i njëjtë për secilin prej tyre", tha Kurti duke komentuar tekstin, me të cilin kanë dhënë dorëheqje këta zyrtarë.

Kurti tha, gjithashtu, se "nuk është e vërtetë që në veri të Kosovës nuk ka polici" pas dorëheqjes së serbëve. "Nuk ka ndërtesë të policisë pa polici të Kosovës. Policia jonë është atje. Edhe nëpër rrugët atje ka policë të Kosovës", tha Kurti. Ai tha se vazhdimisht bën thirrje që serbët të mos largohen nga institucionet e Kosovës mirëpo, sipas tij, nuk

mund të bëhet thirrje politike për kthim. "Aty ku ka vakum duhet të ketë aplikime të reja për punë. Vendimi politik i dorëheqjes nuk mund të pasohet me thirrje politike për kthim, por me aplikim profesional", tha Kurti.

Presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, më 24 nëntor konfirmoi se serbët nga veriu i Kosovës do të kthehen në institucionet e Kosovës kur të plotësohet kushti i dytë, pra të formohet Asociacioni. Ky Asociacion është pranuar në kuadër të dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, por është i papranueshëm për Qeverinë e Kosovës, sepse e sheh atë si trup monoetnik.

Para fjalimit të Kurtit, Ramush Haradinaj, lider i partisë opozitare Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, e propozoi një rezolutë për votim në Kuvend që, ndër të tjera, kërkon që "institucionet e Kosovës në të gjitha nivelet ta fillojnë dialogun intensiv me serbët e Kosovës për t'u kthyer në institucionet e Kosovës dhe për ta kthyer besimin e ndërsjellë". Kjo rezolutë e AAK-së nuk mori votat e mjaftueshme.

Në anën tjetër, Enver Hoxhaj, deputet opozitar nga Partia Demokratike e Kosovës, reagoi ndaj fjalimit të Kurtit, duke thënë se situata në veri të vendit "nuk është vetëm vakum institucional". "Është humnerë politike. Aktualisht nuk ka as institucione shtetërore (në veri), as proces politik për t'i krijuar ato. Situata në veri të vendit ka qenë çdoherë komplekse, por pas 5 nëntorit (dita e nisjes së dorëheqjeve) është një kolaps shtetëror", tha ai.

Ndërkaq Lumir Abdixhiku nga Lidhja Demokratike e Kosovës, po ashtu parti opozitare, i kërkoi



Kurtit koordinim me aleatët ndërkombëtarë të Kosovës dhe arritjen e një marrëveshjeje finale me Serbinë. "Kosova duhet të kërkojë marrëveshje finale, jo të mesme, jo fillestare. Duhet të flasë vetëm për njohje të ndërsjellë e jo për implikime të tjera që atakojnë edhe interpretimin e shpalljes së pavarësisë së Kosovës dhe lënë hapësirë për ndonjë interpretim të ri", theksoi ai.

Më 23 nëntor Kosova dhe Serbia kanë arritur marrëveshje për targat nën ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian.

Marrëveshja parasheh që Kosova ta pezullojë planin për reregjistrim të makinave dhe që Serbia të mos lëshojë më targa serbe për qytetarët në Kosovë.

Kurti, deputetëve: Të gjithë duhet të gëzohemi që Kosova ka një qeveri që nuk varet nga Lista Serbe

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se në të kaluarën qeveritë janë varur nga Lista Serbe, kurse tash kjo gjë nuk ndodh. "Sikur të ishim në qeveritë e kaluara ku shumica bëhej e varej nga Lista Serbe me siguri që do të bëhej mocion mosbesimi për ta rrëzuar qeverinë, por ja që kjo nuk është e mundur tash. Reciprociteti me targa dhe letërnjoftime do të ishte motiv i mjaftueshëm për ata që të provojnë ta rrëzojnë qeverinë. Ka ndodhur ndryshimi i madh dhe të gjithë duhet të gëzohemi që Kosova ka një qeveri që nuk varet nga votat e Listës Serbe", ka thënë Kurti.

Ish-këshilltari i Thaçit: Prokuroria e Speciale është furnizuar me dezinformata nga Serbia

PRISHTINË, 30 NËNTOR - Ish-këshilltari i Hashim Thaçit, Artan Behrami, ka theksuar se Prokuroria e Gjykatës Speciale është furnizuar me dezinformata nga Serbia. Sipas tij, Prokuroria e Gjykatës Speciale ka punësuar pjesëtarë të BIA-s në Gjykatën Speciale. "Prokuroria e Gjykatës Speciale është furnizuar me dezinformata nga Serbia. Prokuroria e Gjykatës Speciale ka zyrë në Beograd. Prokuroria e Gjykatës Speciale ka dëshmitarë që kanë punuar për BIA. Prokuroria e Gjykatës Speciale ka krijuar dosje trefish më të madhe për krerët e UÇK-së sesa për kasapin Millosheviq. Prokuroria e Gjykatës Speciale ka punësuar pjesëtarë të BIA-s në Gjykatën Speciale. Prokuroria e Gjykatës Speciale ka fshehur gjatë gjithë kohës dokumente shfaqësuese për krerët e UÇK-së", ka shkruar Behrami në "Facebook".

Sipas Behramit, Prokuroria e Gjykatës Speciale ka kërkuar që të refuzohet çdo kërkesë e mbrojtjes për mbrojtje në liri. Ai thotë se

Prokuroria e Gjykatës Speciale ka shkelur të gjitha konventat ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. "Prokuroria e Gjykatës Speciale nuk pranon dëshmitarë ndërkombëtarë të cilët kanë ndihmuar në çlirim të Kosovës. Prokuroria e Gjykatës Speciale e pranon Kushtetutën e Kosovës vetëm në versionin serbisht. Prokuroria e Gjykatës Speciale nuk ka dënua personat që kanë rrjedhur dokumentet e Gjykatës Speciale. Prokuroria e Gjykatës Speciale nuk i njeht krimet serbe në Kosovë. Prokuroria e Gjykatës Speciale nuk i njeht 400 masakra serbe në Kosovë. Prokuroria e Gjykatës Speciale nuk e njeht vrasjen e mbi 1300 fëmijëve shqiptarë. Prokuroria e Gjykatës Speciale nuk e njeht dhunimin e 20 mijë femrave shqiptare në luftën e fundit. Prokuroria e Gjykatës Speciale nuk është në shërbim të drejtësisë, por në shërbim të Serbisë dhe Rusisë", ka shkruar ish-këshilltari i Thaçit, Artan Behrami.



Qeveria ndan shtatë milionë euro për punëtorët e sektorit publik dhe studentët

PRISHTINË, 30 NËNTOR - Qeveria e Kosovës në mbledhjen e 110 ka miratuar kërkesën e Ministrisë së Financave për ndarjen e mjeteve prej 7 milionë eurove për shtesat ndaj punëtorëve të ndërmarrjeve publike dhe për

studentët. Po ashtu, me këto mjete do të bëhet subvencionimi i kredive investive të Pakos së Ringjalljes Ekonomike. “Miratohet kërkesa e Ministrisë së Financave, Punës dhe

Transfereve për ndarje të mjeteve buxhetore prej 7 milionë eurosh për zbatimin e pikës 1.4 dhe 1.6 të Vendimit nr. 31/99 të datës 30.09.2022, përkatësisht për pagesat e njëhershme për punëtorët e

ndërmarrjeve publike dhe pagesat e njëhershme për studentët dhe për zbatimin e Masës 2.1 - Subvencionimi i kredive investive të Pakos së Ringjalljes Ekonomike”, thuhet në vendim.



Agjencia Federale e Punës: Gjermania ka nevojë për më shumë punëtorë të huaj



PRISHTINË, 30 NËNTOR - Agjencia Federale e Punës në Gjermani ka njoftuar se ekonomia dhe kompanitë e mesme mbështetin ardhjen e fuqisë punëtore nga vendet e tjera. “Ekonomia nuk mund të funksionojë në formën e tanishme pa punëtorët shtesë”, është theksuar një njoftimin e kësaj agjencie.

Shefja e Agjencisë Federale të Punës, Andrea Nahles, ka bërë thirrje për më shumë emigracion në Gjermani. “Për shkak të ndryshimit demografik, nuk ka asnjë skenar ku mund t’ia dalim pa emigracion të madh”, ka theksuar Nahles për gazetën “Suddeutsche Zeitung”. “Republika Federale ka nevojë për rreth 400 mijë punëtorë shtesë dhe punëtorë të kualifikuar në vit”, shtoi ish-shefja e Partisë Socialdemokrate (SPD), tani drejtuese e Agjencisë Federale të Punës. “Punëtorët e

huaj ende duhet të kapërcejnë një numër relativisht të madh pengesash për ardhjen në Gjermani. Kjo fillon me pengesat në lëshimin e vizave dhe kalon përmes zyrave të imigracionit me staf të pamjaftueshëm e deri te njohja e diplomave dhe barrierat gjuhësore. Prandaj, politikanët duhet të veprojnë dhe t’i lehtësojnë gjërat”, mendon Nahles.

Sigurimi i punëtorëve të kualifikuar është çështja qendrore e tregut të punës. Në të njëjtën kohë, kreu i Agjencisë Federale të Punësimit paralajmëroi se edhe potenciali i brendshëm i punëtorëve duhet të shfrytëzohet më mirë. “75 për qind e grave janë të punësuar, por shumë punojnë me kohë të pjesshme. Të rinjtë me prejardhje migrimi duhet të mbështeten më shumë se më parë”, tha ajo.

Gratë me prejardhje migrimi kanë shpesh më shumë pengesa në tregun gjerman të punës. “Edhe të moshuarve apo të papunëve nuk u janë dhënë mundësi të mjaftueshme deri më tani”, tha Nahles. Në këtë kuadër, kryetarja e ekspertëve ekonomikë, Monika Schnitzer, mbështeti reformën e ligjit të shtetësisë të planifikuar nga qeveria federale. Marrja më e lehtë e shtetësisë forcon integrimin e të huajve që jetojnë dhe punojnë në Gjermani, tha për gazetën e grupit Funke kryetarja e këshillit të ekspertëve, duke folur për zhvillimet e përgjithshme ekonomike. “Në funksion të ndryshimit demografik dhe mungesës në rritje të punëtorëve, në veçanti punëtorëve të kualifikuar, kjo është padyshim për t’u mirëpritur”, tha Schnitzer. Shoqata Federale e Bizneseve të Mesme (BVMW) gjithashtu

mbështet këto plane. Reduktimi i pengesave burokratike në natyralizimin e inxhinierëve të softuerëve si dhe personelit të infermierisë mund të jetë një avantazh i rëndësishëm për ardhjen dhe mbetjen e tyre në Gjermaninë në terma afatgjatë, tha drejtori i rrjetit editorial Gjermani (RND), Markus Jerger. Qeveria federale dëshiron t’i ulë pengesat ligjore për marrjen e shtetësisë gjermane. Në të ardhmen duhet të jetë e mundur të merret shtetësia pas vetëm pesë vjetësh qëndrimi në Gjermani, në vend të tetë vjetëve siç është tani. Në rastin e “arritjeve të veçanta të integritit” kjo duhet të jetë e mundur pas tre vjetësh. Partitë e Unionit e refuzojnë projektin, e rezerva ka edhe një pjesë e partisë liberale në pushtet, FDP. Ndërkohë, Enti Federal i Statistikave njoftoi se në gjysmën e parë të vitit 2022 më

shumë se një milion njerëz me shtetësi të huaj kanë ardhur në Gjermani. Emigracioni neto nga janari deri në qershor ishte 1.046.000, sipas zyrës me seli në Wiesbaden. Kjo është vlera më e lartë brenda një gjysmë viti, që nga ribashkimi i Gjermanisë në vitin 1990.

Popullsia në Republikën Federale u rrit me 2.9 milionë nga fundi i vitit 2014 deri në mes të vitit 2022. Por numri i njerëzve me shtetësi gjermane është zvogëluar, thonë statisticienët. Rritja është kryesisht për shkak të migrimit të refugjatëve nga rajonet e përfshira në luftë dhe dhunë, si në Siri, Afganistan dhe Irak në 2015/2016. Por numri këtë vit është shtuar veçanërisht për shkak të agresionit të Rusisë në Ukrainë, e flukse mjaft të mëdha ka edhe nga vendet e BE-së, si Rumania, Bullgaria dhe Polonia. /dw/

Subvencionimi i pajisjeve eficiente për ngrohje, Kurti fton qytetarët për aplikim

PRISHTINË, 30 NËNTOR - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka bërë me dije se kanë mbetur edhe tri ditë nga thirrja për subvencionim të pajisjeve eficiente për ngrohje, e cila është e hapur për aplikim deri më 2 dhjetor. Sipas tij, subvencionimi direkt i

stufave individuale, kaldajave me biomasë, pompave termike e kondicionerëve eficientë, do t’u ndihmojë qytetarëve ta tejkalojnë sa më lehtë dimrin, por edhe sistemin tonë energjetik duke ulur konsumin. “Kjo është kritike në përballjen tonë

me krizën energjetike evropiane. Ju ftoj veçanërisht juve qytetarë përfitues të asistencës sociale si dhe juve nëna vetushqyese që të aplikoni e përfitoni nga kjo mbështetje e qeverisë”, ka shkruar Kurti me anë të një postimi në “Facebook”.



Lajmet e rreme që e ndryshuan historinë



Nga Roberto VIVALDELLI

Gazetaria e sotme synon që të respektojë të vërtetën thelbësore të fakteve. Kjo do të thotë se të gabosh është njerëzore – edhe në botën e gazetave dhe mediave – por me kushtin që kjo të bëhet me ndershmëri, etikë dhe duke bërë gjithçka që është e mundur për të raportuar lajme që i respektojnë këto norma morale dhe profesionale. E megjithatë, historia e “fake news” (lajmeve të rreme) po zgjat prej shekujsh, dhe nuk shqetëson vetëm botën e medias por edhe atë të politikës. Ja cila janë disa prej tyre që e ndryshuan historinë.

Bernardino Da Feltre (1439-1494) dhe Simonino da Trento

Ngjarja zhvillohet në qytetin italian të Trentos, të dielën e Pashkëve të vitit 1475. Një djalë dy vjeç e gjysmë i quajtur Simonino zhduket. Predikuesi françeskan Bernardino da Feltre mban një seri predikimesh, duke pretenduar se fëmija ishte vrarë nga komuniteti hebre, që ia kishte marrë gjakun dhe e kishte pirë për të kremtuar Pashkët.

Padyshim ishte një akuzë fare e pabazë, por ky thashethem u përhapën me shpejtësi në qytet. Më vonë, Da Feltre pretendoi se trupi i djalit u gjet në bodrumin e një shtëpie hebreje. Për këtë arsye, Kryepeshkopi i Trentos, Xhovanni Hinderbah, urdhëroi menjëherë arrestimin dhe torturimin e të gjithë komunitetit hebre të qytetit.

15 hebrej u konsideruan fajtorë dhe u dogjën në turrën e druve. Edhe pse Papatë u përpoq të ndalonte Hinderbahun në këto veprime, ky i fundit refuzoi që të takonte të dërguarit e Papës. Dhe duke u ndjerë i kërcënuar, përhap akoma më shumë informacione të rreme për hebrejtë, që sipas tij pinin gjakun e fëmijëve të krishterë.

Mbreti Xhorxh II

Në mesin e viteve 1700, media ndihmoi në përhapjen e lajmeve të rreme për shëndetin e Xhorxhit II, që në atë kohë ishte Mbreti i Britanisë së Madhe dhe Irlandës. Ai po përballej me një rebelimin, dhe duhej të tregojë një udhëheqës i fortë për t'u siguruar që rebelimi të mos kishte sukses.

Lajmet e rreme mbi “sëmundjen” e mbretit u përhapën enkas nga rebelët. Kjo e dëmtoi imazhin publik të sovranit, dhe ndonëse rebelimi rezultoi në fund i pasuksesshëm, kjo ngjarje tregoi se si mund të përdoren lajmet e rreme për të ndryshuar opinionet e njerëzve, dhe për të ndikuar në fatin e një ngjarjeje të madhe, si një luftë ao një rebelim. Në këtë aspekt, asgjë nuk ka ndryshuar në thelb që atëhere.

Përhapja e gazetave dhe sensacionalizmi mediatic

Me rritjen e ndryshme të tirazhit të gazetave midis viteve 1700 dhe 1800, u shtuan edhe mashtrimet që shkruheshin në to, me synim shkaktimin e bujës, që nga ana e saj do të rriste numrin e kopjeve të shitura. Sensacionalizmi shet

gjithmonë, dhe në fillimin e shekullit XIX-të hynë në skenë gazetave moderne, të cilat propagandonin histori të rreme për të rritur tirazhin e gazetave. Mashtrimi i madh i hënës nga gazeta “New York Sun” e vitit 1835, pretendonte se në Hënë kishte një qytetërim alien. Në një shembull tjetër, në vitin 1844, gazetave anti-katolike në Filadelfia përhap lajmin e rreme se irlandezët po vidhnin Bibla nga shkollat publike, duke shkaktuar trazira të dhunshme dhe sulme ndaj kishave katolike.

Mashtrime dhe propagandë lufte

Rreth vitit 1890, 2 botuesit rivalë të gazetave më të mëdha amerikane, Xhozef Pulicer dhe Uilliam Hwrst, e sfiduan njëri-tjetrin përmes sensacionalizmit, duke i raportuar thashethemet sikur të ishin fakte, një praktikë që u bë e njohur në atë kohë si “gazetaria e verdhë”.

Lajmet e tyre të shtrembëruara luajtën një rol qendror në futjen e Shteteve të Bashkuara në Luftën Spanjollo-Amerikane të vitit 1898. Atë vit në Kubë u mbyl një anije e Marinës së Shteteve të Bashkuara, USS Maine. Disa gazeta të kohës fajësuan spanjollët për fundosjen, dhe përdorën si ilustrim një shpërthim dramatik për të bindur lexuesit dhe për të rritur emocionalitetin e ngjarjes.

Një histori tjetër e rreme daton në vitin 1917, gjatë Luftës së Parë Botërore. Gazetat britanike si “Times” dhe “Daily Mail” raportuan një histori të tmershme duke pretenduar se gjermanët po

nixirnin yndyrë nga trupat e ushtarëve të vdekur për të bërë sapun. Historia u trillua nga një departament zyrtar i qeverisë britanike dhe më pas iu shpërnda shtypit.

Zyrtarët e dinin që ky lajm nuk ishte i vërtetë, por ishte e nevojshme që lexuesit të bindeshin se gjermanët ishin një armik barbar, i cili duhej mposhtur. Një tjetër mashtrim më afër në kohë, ka të bëjë me Kolin Pauell dhe fjalimin e tij të famshëm në Këshillin e Sigurimit të OKB-së, në vitin 2003, kur ai vendosi të paraqesë gjetjet e supozuara nga Shtetet e Bashkuara për shkeljet e rezolutës 1441 të OKB-së, dhe për zotërimin e armëve të shkatërrimit në masë nga Iraku i Sadam Huseinit.

Lajmi u përhap me shpejtësi nga gazetave dhe televizionet në të gjithë botën. Kështu Perëndimi e gjeti veten në luftë me Irakun, që së shpejti u pushtua nga koalicioni perëndimor. Sadam Huseini u rrezua dhe kështu u arrit qëllimi i “ndryshimit të regjimit”.

Lajmet e rreme sot

Vitet e fundit, dhe sidomos nga viti 2016 e në vazhdim, me zgjedhjen e Donald Trump president të SHBA dhe referendumin pro Brexit, ka pasur një bum të “fake news” për shkak të historive të rreme të shpërndara gjerësisht në mediat sociale, pa u verifikuar nga përdoruesit.

Kjo ka çuar në vendosjen e disa masave kufizuese për këto lloje lajmesh, që kënaqshëm akuzat për çensurë. Pra, lamtumirë lajmeve të rreme? Sigurisht që jo.

Lufta në Ukrainë, si në çdo konflikt tjetër, është shoqëruar me përdorimin masiv të keqinformimit dhe propagandës nga të dyja palët, të përhapura përmes rrjeteve sociale dhe kanaleve në Telegram që janë të vështira për t'u kontrolluar dhe jo gjithmonë të verifikueshme.

Mashtrimi i fundit i njohur – por ka shumë të tjerë në frontin e kundërt – u përhap nga Ministria e Mbrojtjes së Ukrainës, që foli për një “mini-Aushvic” në Peski-Radkovski.

Serhi Bolvinov, kreu i departamentit të hetimit të Shërbimit të Sigurisë në rajonin Harkiv, kishte fotografuar një maskë kundragaz dhe një kuti plot me dhëmbë njerëzish, duke evokuar kampet naziste të përqendrimit.

Lajmi daton në fillim të tetorit dhe u mor pa shumë verifikime nga mediat dhe u cilësua si i vërtetë. Më pas gazeta gjermane “Bild”, dërgoi disa gazetarë në atë vend, për të demaskuar një tjetër mashtrim të prodhuar nga propaganda e luftës. Në fakt, korrespondentët e gazetës gjermane intervistuan një dentist që njohu kutinë me dhëmbë që ishin vjedhur.

“Dhëmbët duket se m'i kanë vjedhur në zyrë, rusët më kanë grabitur shtëpinë. Këta janë dhëmbët e njerëzve që kam trajtuar gjatë gjithë këtyre viteve”- tha dentisti. Prandaj, nuk ka një “mini-Aushvic”. Sepse në një luftë, viktimat e parë është gjithmonë e vërteta. Dhe iluzioni se kjo gjë nuk ndodh në luftërat hibride bashkëkohore, është i rrezikshëm.

| “Il Giornale” – Bota.al

EURO GLASS
 SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
 Enveri
 Adr: Fushë Kosovë
 Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
 E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
 TEL: 045/82 82 82

Riga Dresha, karateistja që premtion shumë

"Epoka e re"

PRISHTINË, 30 NËNTOR - Riga Dresha, karateistja nga Peja, e cila jeton në Prishtinë, është nxënëse e shkollës "Hasan Prishtina". Riga, përpos shkollës, ajo i kushton shumë rëndësi edhe sportit, në veçanti sporteve luftarake. Ajo me karate ka nisur të merret që nga mosha shtatëvjeçare, ku po atë vit e fitoi edhe titullin e parë, ndërsa deri më tani numëron 63 medalje; 53 të arta dhe të tjerat të argjendta e bronza. Riga bën pjesë në Klubin e Karatesë "Prishtina", ndërsa tash në moshën 12-vjeçare është pesë herë kampione e Kosovës si dhe e rajonit, njëherësh kampione mbarëkombëtare. Në një bisedë për gazetën "Epoka e re", ajo ka theksuar se pret ta përfaqësojë Kosovën edhe në gara ndërkombëtare për t'i sjellë vendit medalje.

Riga buzëqeshet dhe me krenari thotë se në një të ardhme të afërme do të ngrahet flamuri i Kosovës edhe për të. "Do të ushtroj shumë që të sjell në Kosovë medalje të arta, ashtu siç po sjellin edhe sportistët e tjerë nga garat ndërkombëtare", është shprehur me plot entuziazëm, e ardhmja e Kosovës në karate, Riga Dresha. Kujtojmë se karateistja Riga Dresha, para se të merret me sportin e karatesë, ajo është marrë që nga mosha katërvjeçare edhe me balet, ku në atë kohë ishte përzgjedhur ndër balerinat më të mira në Kosovë. Riga ka marrë pjesë edhe në gara ndërkombëtare si në Maqedoni, Mal të Zi dhe Shqipëri. Po ashtu, Riga ka pasur ftesë të marrë pjesë edhe në garat që janë mbajtur në Kroaci, por kishte pësuar një lëndim serioz duke ia pamundësuar pjesëmarrjen në këtë garë.



Grupi C: Kualifikohen Argjentina dhe Polonia



Doha, 30 nëntor - Argjentina dhe Polonia janë dy ekipet që janë kualifikuar për në raundin tjetër të Kupës së Botës. Argjentina fitoi me lehtësi 2-0 ndaj Polonisë. Në pjesën e parë dominimi ishte i madh, por portieri Szczesny ishte i jashtëzakonshëm me pritjet e tij. Portieri i Juventusit shkaktoi penallti në minutën e 38-të pas një faulli ndaj Messit, por më pas do të bënte një pritje shumë të bukur

ndaj tij, duke e ndalur nga pika e bardhë. Në fillimin e pjesë së dytë, do të zhblllokohej dhe ndeshja. Molina del mjaft mirë në krahun e djathtë dhe krosin në zonë, atje MacAllister me një goditje të saktë mposht portierin e polakëve. Argjentina dyfishoi avantazhin ndaj Polonisë në minutën e 67-të me anë të Alvarez. Meksika është eliminuar vetëm për shkak të diferencës së golave, pasi mori një

fitore 2-1 ndaj Arabisë Saudite.

Grupi D: Kualifikohen Franca dhe Australia

Kombëtarja e Francës e mbyll grupin D në vendin e parë me 6 pikë, pavarësisht humbjes 1-0 ndaj Tunizisë. Golin e shënoi Khazri në minutën e 58-të. Tunizia përfundon fazën e grupeve në



vendin e tretë dhe e mbyll këtu rrugëtimin e Botërorit. Australia arriti ta mund Danimarkën me rezultatin minimal 1-0, duke hipotekuar kështu vendin e dytë në grup. Siç pritej ndeshja nisi me dominimin e danezëve me Maehle, Braithwait e Skov Olsen, të cilët goditën portën australiane, por pa mundur të shënonin. Gjatë gjithë ndeshjes Danimarka ishte në sulm dhe të gjithë mendonin se rezultatit

do të ishte në favor të "nordikëve", por në minutën e 60', një pasim i bukur në zonë nga McGree gjen të "zbuluar" sulmuesin Leckie, i cili me një goditje ultazi, në cepin e djathtë të portës nuk di të gabojë, duke çuar në delir tifozët australiane. Australia tashmë është pozicionuar në vendin e dytë me 6 pikë, po aq sa Franca e vendit të parë, por me më pak gola të shënuar.

Ballkani shpëton nga humbja ndaj Trepçës '89

MITROVICË, 30 NËNTOR - Kampioni i Kosovës në futboll, Ballkani, ka shpëtuar nga humbja në përbalje me Trepçën '89, pasi ka barazuar rezultatin

në minutat shtesë të ndeshjes. Ndeshja përfundoi me rezultat 1-1 dhe ishte ndeshje e mbetur e javës së tretë në Superligë. Në minutën e 76 vendasit

kaluan në epërsi me golin që realizoi Fatty. Mysafirët tentuan ta barazojnë rezultatin me të gjitha forcat dhe një gjë të tillë e arritën në minutat shtesë, kur

Ermal Krasniqi shënoi për 1-1. Pas kësaj ndeshje Ballkani mbetet në pozitën e dytë me 34 pikë, ndërsa skuadra e Trepçës është në vendin e parafundit me 19 pikë.



Kuzmanoviç, lojtarëve serbë: Hakmerruni ndaj Xhakës e Shaqirit!

CYRIH, 30 NËNTOR - Zdravko Kuzmanoviç ka shtetësi të dyfishtë zvicerane-serbe, por që kishte veshur fanellën e Serbisë. Ish-futbollisti i Interit, Fiorentinës, Shtutgartit, Baselit, Udineses e Malagas duket se nuk e ka harruar ende

shqiponjën e Xhakës e Shaqirit dhe ka porositur lojtarët serbë që të hakmerren ndaj dy shqiptarëve në fushë. Ai ka thënë se po të ishte në fushë në ndeshjen e të premtes, do t'i trondiste që të dy. "Ngjarjet në 'Rusi 2018' nuk mund të

harrohen. Nëse jeni provokues, duhet të jeni të përgatitur që gjërat të tronditin në fushë. Një thënie e bukur thotë se gjithmonë takohesh dy herë në jetë. Nëse do të isha ende lojtar, do t'i tronditja në fushë Xhakën e Shaqirin. Nuk


mendoj se djemtë që ishin atje në 2018-n ndaj Zvicrës në fushë do ta harrojnë lehtë shqiponjën e tyre. Shqiponja e bërë nga ta ishte një turp. Duhet të ndash sportin nga politika, djemtë nuk e bënë këtë", ka thënë Kuzmanoviçi.



Rashfordi dhe historia tragjike që qëndron pas dygolëshit të shënuar ndaj Uellsit

LONDËR, 30 NËNTOR - Marcus Rashford shënoi dy goditje për Anglinë kundër Uellsit të martën në mbrëmje, duke e dërguar skuadrën e tij në fazën eliminatorë të Kupës së Botës. Por fitorja 3-0 ishte akoma më e veçantë për yllin e "Tre Luanëve" pasi ai ia dedikoi një miku që humbi jetën vetëm disa ditë më parë. 25-vjeçari realizoi golin e parë me një goditje dënimi, kurse golin e realizoi pas një aksioni. Ai festoi duke u ulur në gjunjë dhe duke treguar qiellin me sy të mbyllur dhe më vonë zbuloi se po i bënte homazh shokut të humbur Garfield Hayward. Duke folur pas ndeshjes, Rashford ka thënë: "Fatkeqësisht, kam humbur një nga miqtë e mi disa ditë më parë. Ai ka pasur një betejë të gjatë me kancerin, kështu që jam i kënaqur që arrita të shënoj për të. Ai ka qenë gjithmonë një mbështetës i madh. Ai ishte thjesht një person i mrekullueshëm dhe jam i kënaqur që ai erdhi në jetën time, me të vërtetë".

Rrjetet sociale janë përmbytur me homazhe për "Garf", të cilin miqtë e përshkruan si "një legjendë, gjithmonë". Calder Taylor, i cili ndau



një video emocionuese: "Prehu në paqe, vëllai im! Unë do të të dua gjithmonë". Ndërsa një tjetër postoi: "Një nga njerëzit më të këndshëm që pata kënaqësinë të takoja". Dhe "MailOnline" raporton se nipi i tij Steven ka shkruar: "Zemra ime po dhemb aq shumë duke ditur që nuk do të të shoh më në këtë jetë". "Xha Garf, një nga njerëzit më të vërtetë që kam njohur ndonjëherë. Ti do të jesh përgjithmonë në mendimet dhe zemrën time deri në ditën që do të vdes". Anglia ka kaluar në 1/8-at ku do të përballet të dielën me Senegalin. Rashford beson se

skuadra e Gareth Southgate është mjaft e fortë për të ngritur një sfidë serioze në fazat e eliminimit. "Ndihem sikur ambicia në skuadër është vërtet e mirë. Ne kemi një përzjerje të mirë cilësish. Kemi një skuadër vërtet të mirë dhe një skuadër që është padyshim e aftë të sfidojë për ta fituar turneun. Shpresoj që ne mund t'i japim vazhdimësi kësaj paraqitje, të vazhdojmë të përmirësohemi dhe të vazhdojmë të shënojmë gola dhe të tregojmë cilësitë tona", ka deklaruar ylli i Manchester Unitedit.

Reja nuk e rinovon kontratën, Shqipëria mbetet pa trajner

TIRANË, 30 NËNTOR - Trajneri italian Edy Reja zyrtarisht nuk është më trajneri i kombëtares shqiptare të futbollit. Kontrata e Rejas me FShF-në ka përfunduar të mërkurën, duke mbyllur kështu marrëveshjen mes dy palëve, teksa ende nuk ka një zëvendësues për stolin. Ndeshja me Armeninë praktikisht ishte e fundit për italianin 77-vjeçar dhe pak ditë më parë i përfundoi edhe kontrata duke dalë kështu një trajner i lirë. Për shkak të rezultateve jo të mira të ekipit kombëtar nën drejtimin e tij nuk pritet një rinovim kontrate, megjithatë mbetet të shihet se çfarë do të ndodhë në ditët në vijim. Edy Reja u konfirmua në stolin e Shqipërisë në prill të vitit 2019, ku zëvendësoi të larguarin Panuçi. Reja e ka drejtuar Shqipërinë në 38 ndeshje në total, ku ka arritur të regjistrojë 14 fitore, 9 barazime dhe 15 humbje,



me një golavarazh të përgjithshëm 46 të shënuar dhe 45 të pësuar. Teknika ka aplikuar në pothuajse të gjitha ndeshjet skemën 3-5-2 dhe për 3 vjet e 7 muaj në krye të stolit ka provuar një numër të lartë lojtarësh që e kalon shifrën 40. Suksesi i tij i parë ishte në Ligën e Kombeve, ku Shqipëria u ngjiti nga Liga C në B. Gjithashtu, në kualifikueset e

Botërorit 2022 ai grumbulloi më shumë pikë se çdo trajner tjetër në grupe (18), por gjithsesi në fund u rendit i treti në grup pas Anglisë dhe Polonisë. Ndërkohë kompeticioni i fundit, që ishte Liga e Kombeve e këtij sezoni, rezultoi një dështim për teknikun italian, ku Shqipëria u rendit e fundit në grup duke mos fituar asnjë takim.

SHKURT

Lille interesohet për Kumbullën

Kampioni në fuqi i Francës, Lille, ka piketuar mbrojtësin e Kombëtares së Shqipërisë, Marash Kumbulla, si zëvendësues për kapitenin Jose Fonte, i cili është në përfundim të karrierës. Kumbulla është pjesë e skuadrës së Romës, por nuk po pëlqehet shumë nga Jose Mourinho. Mbrojtësi kuqezi pëlqehet nga trajneri i Lilles, Paulo Fonseca dhe transferimi në Francë mund të realizohet gjatë afatit kalimtar të janarit.

Southgate: Senegali është një skuadër e rrezikshme

Anglia kalon në fazën e 1/16 ku do të përballet me Senegalin. Trajneri i "tre luanëve", Gareth Southgate, ka thënë se kundërshtari është i rrezikshëm dhe se ka shumë lojtarë cilësorë. "Senegali? Ka disa lojtarë të mëdhenj që luajnë në kampionate të mëdha. Ne e dimë që jemi favoritë, por luajmë kundër një skuadre të rrezikshme", ka thënë Southgate.

Ronaldo, afër marrëveshjes me Al-Nassrin

Cristiano Ronaldo pritet ta vazhdojë karrierën e tij në Arabinë Saudite. Pesë herë fituesi i "Topit të Artë", Cristiano Ronaldo, e ka shkëputur bashkëpunimin me Manchester Unitedin, ndërsa tash është afër marrëveshjes me skuadrën Al-Nassr. Ronaldo është gati të firmosë kontratë dyvjeçare me klubin nga Arabia Saudite. Me këtë kontratë portugezi do të fitonte rreth 200 milionë euro për sezon, përfshirë pagën dhe marrëveshjet për marketing.

Kahn: Neueri mund të jetë në Bayern edhe pas moshës 40-vjeçare

Portieri Manuel Neuer mund të jetë pjesë e Bayern Munchenit edhe pas moshës 40-vjeçare. Shefi ekzekutiv i Bayernit, Oliver Kahn ka folur për mundësinë e vazhdimin të kontratës me portierin dhe kapitenin aktual. "Manueli vazhdon të sjellë paraqitje të kalibrit botëror, dhe për aq gjatë sa rasti qëndron kështu, ai mund të vazhdojë derisa t'i mbushë 40. Ai mund ta bëjë atë edhe pas 40. Prandaj pse të mos rinovojmë kontratat e tij?", ka thënë Kahn. Portieri Neuer është 36-vjeçar dhe ka kontratë me Bayernin deri në vitin 2024, por me shumë gjasë do të marrë një ofertë rinovimi.

Golden State pëson humbje nga Dallasi, fitojnë clippersat dhe New York

Tri ndeshje të luajtura në NBA. Ekipi kampion i Golden States u mund me rezultat 116-113 nga Dallasi, në një ndeshje me shumë rivalitet dhe emocione deri në fundin e saj. Stephen Curry realizoi 32 pikë për kampionët, por që s'mjaftuan për ta evituar humbjen. Në kahun tjetër, Luka Donçiq realizoi një "triple double", me 41 pikë, 12 rebounde e 12 asistime. Skuadra e clippersave, falë 32 pikëve të Powellit dhe 24 të Jacksonit, mposhti me rezultat 118-112 Portlandin, ndeshje e hapur deri në fund. Për Portlandin u dallua Granti me 32 pikë, por që mbetën për statistikë. Fitore të thellë korri New Yorku, që mundi me rezultat 140-110 Detroitin. Randle me 36 pikë ishte lider në fushë për nju-jorkezët në këtë sfidë.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria –Vlada-Government
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRIUR
AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Nr. 1707/1
Datë: 30.11.2022

Në bazë të Ligjit nr. 04/L-032 Për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, në bazë të Ligjit të Punës nr. 03/L-212, Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional 04/L-138, në bazë të nenit 4 paragrafi 2 pika 2.3 të Udhëzimit Administrativ të MASHT-it nr. 151/2020 për Detyrat dhe Përgjegjësit e Drejtorit dhe të Zëvendës Drejtorit të Institucionit Publik Edukativo-Arsimor dhe Aftësues Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Procedurat e Zgjedhjes dhe Emërimit, Përfundimit të Kontratës dhe Emërimit të Përkohshëm, Udhëzimit Administrativ 05/2012, Udhëzimit Administrativ 14/2014, Agjencia e AAAPARr-së, shpallë këtë:

RI-SHPALLJE E KONKURSIT
PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË PUNËS

Agjencia e Arsimit dhe Aftësimin Profesional dhe Arsimit për të Rritur

I. Titulli i vendit të punës: Drejtor i Qendrës të Kompetencës

Qendra e Kompetencës në Malishevë;

Lloji i Vendit të Punës: Me afat të caktuar, me orar të plotë

Numri i Pozitave: Një (1) pozitë
Kategoria Funktionale: Nivel drejtues
Koeficienti: 8.4
Kohëzgjatja e emërimit: Katër (4) vjet

Qëllimi i vendit të punës:

Udhëheqja, menaxhimi dhe mbikëqyrja e institucionit edukativo-arsimor

DETYRAT KRYESORE TË PUNËS :

- Menaxhimin dhe administrimin e përgjithshëm të institucionit;
- Hartimin e planit vjetor të punës dhe planin zhvillimor të institucionit arsimor dhe raportet vjetore të punës;
- Përdorimin efikas dhe efektiv të sistemit për menaxhimin e informatave në arsim dhe respektimin e kodeve të këtij sistemi, procedurave të sigurimeve dhe afateve të përcaktuara për përditësimin e të dhënave të nevojshme gjatë vitit shkollor;
- Detyrat e caktuara për përzgjedhjen e mësimdhënësve, vlerësimin, disiplinën në institucionin edukativo-arsimor dhe çështje tjera që kanë të bëjnë me mësimdhënësit dhe punëtorët tjerë në arsim;
- Mbështetjen dhe mbikëqyrjen e zbatimit të kurrikulës;
- Mbështetjen dhe mbikëqyrjen e punës së aktiveve dhe bashkëpunësve profesional të institucionit edukativo-arsimor, si dhe mekanizmeve tjera të institucionit arsimor që kanë rol në vlerësimin e performancës dhe menaxhimin e cilësisë së punës së institucionit;
- Bashkëpunon me këshillin drejtues të institucionit edukativo- arsimor (KDSH), Këshillin e Prindërve, Këshillin e Arsimitarëve, Këshillin e Nxënësve dhe komunitetin e institucionit edukativo- arsimor;
- Raporton se paku dy herë në vit para KDSH;
- Siguron ambient të sigurt dhe përkrahës për fëmijët/nxënësit duke përfshirë edhe caktimin dhe aplikimin e masave disiplinore ndaj nxënësve, sipas legjislacionit në fuqi;
- Ruajtjen e dokumenteve dhe të dhënave, siç parashihet nga komuna apo Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASHTI);
- Çështjet e tjera që rregullohen përmes ligjit për arsim parauniversitar, akteve nënligjore të miratuara nga MASHTI;

Kushtet:

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
- Të kenë të kryer arsimin universitar të nivelit: Master për udhëheqje administrim ose menaxhim në arsim (kualifikim prej 300 ECTS, se paku 5 vite të shkollimit universitar);
- Master arsimor (kualifikimin prej 300 ECTS/5 vite të shkollimit universitar); - Katërvjeçar (kualifikimin prej 240 ECTS/4 vite të shkollimit universitar) – Bachelor katërvjeçar (kualifikimin prej 240 ECTS/4 vite të shkollimit universitar);
- Të ketë përgatitje profesionale të profileve përkatëse;
- Të kenë licencë të rregullt të mësimdhënësit sipas udhëzimit për licencim të mësimdhënësit;
- Të kenë përfunduar me sukses një program të akredituar të kualifikimit profesional për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim, të bazuar në standardet e praktikës profesionale për drejtor të shkollave në Kosovë, të aprovuar nga MASHTI sipas rekomandimeve të KSHLM;
- Të ketë së paku 5 vite përvojë pune në procesin edukativo- arsimor;

Dokumentet e domosdoshme:

- Diplomat e fakultetit të kryer për nivelin përkatës të kualifikimit;
- Certifikatat për kryerjen me sukses të programit të trajnimit për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim (në mungesë të certifikatës së trajnimit për udhëheqje në arsim kandidati/ja ofron dëshminë e diplomës Master për udhëheqje);
- Dokumentet personale (certifikata e lindjes dhe letërnjoftimi ose pasaporta);
- Dëshmi se ka licencë të mësimdhënësit ose që është në procedurë të licencimit;
- Certifikatën shëndetësore të lëshuar në gjashtë muajt e fundit nga një institucion i licencuar shëndetësor me të cilën dëshmohet gjendja e tij/saj shëndetësore ;
- Dëshminë se kandidati nuk është nën hetime dhe dëshminë se nuk ka qenë i/e dënuar për krim, dhunë ose vepra të padenja që përfshijnë fëmijët;
- Dëshmi të përvojës së punës në procesin edukativo- arsimor;
- Deklaratën në betim që vërteton se në tri vitet e fundit kandidati/ja nuk ka qenë në asnjë funksion udhëheqës në strukturat e partive politike.

- Portfolio profesionale me dëshmi sipas udhëzimeve në shtojcën/formularin H të këtij UA;

II. Titulli i vendit të punës: Zëvendës drejtor në Qendrën e Kompetencës në Malishevë

Qendra e Kompetencës në Malishevë;

Lloji i vendit të punës: me afat të caktuar, me orar të plotë

Numri i Pozitave: Një (1) pozitë,
Kategoria Funktionale: Nivel drejtues
Koeficienti: 7.8
Kohëzgjatja e emërimit: Katër (4) vjet

Qëllimi i vendit të punës:

Udhëheqja, menaxhimi dhe mbikëqyrja e institucionit edukativo-arsimor

DETYRAT KRYESORE TË PUNËS :

- Zv. Drejtori , është përgjegjës për marrëdhënie me biznese dhe sigurimin e të hyrave.
- Zv. Drejtori i shkollës, është përgjegjës dhe garanton zhvillimin e aktiviteteve për gjenerimin të të ardhurave;
- Organizimin e kurseve të hapura për punonjësit të ndërmarrjeve të komunitetit lokal;
- Organizim e trajnimeve për zhvillimin dhe aftësimin e të papunëve për tregun e punës në bashkëpunim me zyrën e punësimit;
- Organizimin e panairëve për prezantimin e produkteve të kompanive private dhe publike;
- Dhënie me qira të zyrave me të gjitha pajisjet për bizneset private,;
- Ofrim të shërbimeve këshilluese për ish nxënësit e ndërmarrjeve lokale;
- Bashkëpunon ngushtë me kompanitë private dhe publike;
- Siguron mundësinë e aftësimin dhe punësimit të të gjithë nxënësve në organizata të ndryshme private dhe publike brenda dhe jashtë vendit;
- Motivimin për nxënien për të rritur-personeli dhe prindërit;
- Siguron trajnime dhe aftësime që përshtaten nevojave të tregut të punës;
- Bashkëpunon ngushtë me drejtorin dhe zëvendës drejtorin për zhvillimin e arsimit dhe marrëdhënie ndërkombëtare;
- Zv. drejtori i shkollës, menaxhon kohën për t'i arritur objektivat organizative;
- Zv. drejtori i shkollës, duhet të identifikoj problemet e mundshme dhe mundësit;
- Zv. drejtori i shkollës, siguron që hapësirat e shkollës, pajisjet dhe sistemi mbështetës të funksionoj në mënyrë efektive dhe efikase;
- Zv. drejtori i shkollës, në bashkëpunim me drejtorin e shkollës , përdor në mënyrë efektive dhe efikase burimet e disponueshme financiare dhe asetet për të përmirësuar rezultatet e të nxënës;

Kushtet:

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
- Të kenë të kryer arsimin universitar të nivelit: Master për udhëheqje administrim ose menaxhim në arsim (kualifikim prej 300 ECTS, se paku 5 vite të shkollimit universitar);
- Të kenë të kryer arsimin universitar të nivelit: Master nga fushat Ekonomis, kualifikim prej 300 ECTS, se paku 5 vite të shkollimit universitar);
- Katërvjeçar (kualifikimin prej 240 ECTS/4 vite të shkollimit universitar) – Bachelor katërvjeçar (kualifikimin prej 240 ECTS/4 vite të shkollimit universitar);
- Të kenë licencë të rregullt të mësimdhënësit sipas udhëzimit për licencim të mësimdhënësit;
- Të kenë përfunduar me sukses një program të akredituar të kualifikimit profesional për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim, të bazuar në standardet e praktikës profesionale për drejtor të shkollave në Kosovë, të aprovuar nga MASHTI sipas rekomandimeve të KSHLM;
- Të ketë së paku 5 vite përvojë pune në procesin edukativo- arsimor;

Dokumentet e domosdoshme:

- Diplomat e fakultetit të kryer për nivelin përkatës të kualifikimit;
- Certifikatat për kryerjen me sukses të programit të trajnimit për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim (në mungesë të certifikatës së trajnimit për udhëheqje në arsim kandidati/ja ofron dëshminë e diplomës Master për udhëheqje);
- Dokumentet personale (certifikata e lindjes dhe letërnjoftimi ose pasaporta);
- Dëshmi se ka licencë të mësimdhënësit ose që është në procedurë të licencimit;
- Certifikatën shëndetësore të lëshuar në gjashtë muajt e fundit nga një institucion i licencuar shëndetësor me të cilën dëshmohet gjendja e tij/saj shëndetësore ;
- Dëshminë se kandidati nuk është nën hetime dhe dëshminë se nuk ka qenë i/e dënuar për krim, dhunë ose vepra të padenja që përfshijnë fëmijët;
- Dëshmi të përvojës së punës në procesin edukativo- arsimor;
- Deklaratën në betim që vërteton se në tri vitet e fundit kandidati/ja nuk ka qenë në asnjë funksion udhëheqës në strukturat e partive politike.
- Portfolio profesionale me dëshmi sipas udhëzimeve në shtojcën/formularin H të këtij UA;

Shpallja e Konkursit

Paraqitja e dokumenteve bëhet në Agjencinë për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur (AAAPARr). Adresa: Rruga "Agim Ramadani" 10000, Prishtinë, kati i tretë duke filluar nga ora 09.00-15.00. Aplikacioni merret dhe dorëzohet në administratën e AAAPARr-së.

Në aplikacion duhet të ceket qartë titulli i vendit të punës dhe dokumentet e bashkangjitura aplikacionit duhet të jenë kopje dhe nuk kthehen.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë kalendarike nga dita e shpalljes nga dt. 01.12.2022 deri me dt. 15.12.2022

Pas përgatitjes së listës së ngushtë të kandidatëve, këtyre kandidatëve do të ju kërkohen kopjet e dokumenteve të vërtetuara nga organi kompetent (diploma dhe kontrata e punës ose vërtetimi i përvojës së punës) nëse ato nuk janë dorëzuar të vërtetuara.

Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten: Kopja e letërnjoftimit, kopjet e dokumentacionit të kualifikimit, përvojës së punës, si dhe dokumentacionet tjera të nevojshme të kërkuara sipas kushteve të konkursit.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit nuk pranohen, ndërsa aplikacionet e mangëta refuzohen.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR
AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA
ODRASLE
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Nr:1705/1

Dt: 30.11.2022

Në bazë të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-032, Neni 8 i Ligjit të Punës nr. 03/L-212, Neni 13 dhe 34 të Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional 04/L-138, Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2012 (Neni 4), Udhëzimit Administrativ 07/2017 si dhe në bazë të kërkesave të shkollave, Agjencioni për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur shpall:

SHPALLJE E KONKURISIT

Për plotësimin e vendit të lirë në Qendren e Kompetencës në Prizren për vitin shkollor 2022/2023

Niveli	Institucioni/Shkolla	Vendi	Pozita/Vend i ilirë	Vendi lirë/ Zëvendësim
QK	Qendra e Kompetencës	Prizren	Një (1) Punëtor teknik	Vendi lirë

Detyrat dhe Përgjegjësitë kryesore për pozitën: Punëtor teknik

- Bën mirëmbajtjen e pastërtisë së gjithë objektit;
- Ndihmon stafin për rregullimin e orendive të shkollës;
- Ndihmon menaxhmentin/personelin mësimdhënës të shkollës për realizimin e punëve teknike;
- Kujdeset për mirëmbajtjen e infrastrukturës shkollore.
- Merr pjesë në rregullimin e hapësirave të jashtme shkollore, si dhe detyra shtesë të cilat i ndan drejtori i shkollës.

Kualifikimi dhe shkathtësitë e kërkuara:

- Kandidati duhet të ketë Shkollën e mesme,
- Ai ose ajo duhet të jenë gjendje të punojnë nën trysni, të ketë etikë të lartë të punës dhe shkallë të lartë integriteti

Aftësitë shtesë

- Entuziazëm dhe përkushtim personal në mënyrë që të jetë i dobishëm për institucionin,
- Plotësisht i besueshëm ndaj institucionit, objektivave dhe synimeve të stafit drejtues, si dhe personelit të shkollës.

Paga: koef 4

Kontrata: Kohëzgjatja e periudhës provuese është gjashtë (6) muaj

Orari: 40 orë pune në javë

Procedurat e konkurrimit:

- Afati i konkurrimit është 15 ditë nga dita e shpalljes. Aplikacionet dhe dokumentet e kërkuara duhet të merren dhe dorëzohen në administratën e institucionit në të cilin është shpallur konkursi gjegjësisht në Qendrën e Kompetencës në Prizren.
- Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin (për të diplomuarit jashtë vendit dëshmitë e nostrifikimit të diplomës), dëshmia për përvojën e punës, dëshmia që nuk jeni nën hetime dhe dokumentacionet tjera të nevojshme që kërkohen për vendin e punës.
- Kërkesat e arritura pas mbylljes së konkursit, dhe aplikacionet e pa kompletuara nuk shqyrtohen. Kandidatët të cilët do të ftohen në intervistë duhet t'i sjellin në shikim dokumentet origjinale.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë se Kompania "GERTA ENI" SH.P.K" me seli në Prizren ka marr vendim të shuaj biznesin me numër të regjistrimit 811941998 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore-Debitore në këtë shoqëri që të paraqiten në afatin 30 ditorë nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavjestavanosve kliente da tvratka "GERTA ENI" SH.P.K" u Prizren deneo odluku da ugasi biznis po br.registra 811941998 I ujedno imenovao Likfidatora o sprovodjenju postuaka likfidacije.

Obavestavaju se svi klienti koji imaji obaveze I potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all clients that the Company "GERTA ENI" SH.P.K" based in Prizren has taken the decision to terminate the business with registration number 811941998 and has appointed the liquidator to conduct the Liquidation procedure. All clients who have Credit-Debit reports in this company are notified to be presented within 30 days from the date of publication in the newspaper.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Xhemajli Shala shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 811035329

- Artan Rrahmani nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e SH.M. Teknike "Nexhmedin Nixha" Auto Mekanik.

- Infermierja e përgjithshme, Rabe Nikçi nga komuna Pejës me numër personal 1003700182, shpalli të humbur Licencën e Punës me numër: KO-3462-05-20, me afat prej 03.01.2018 deri 03.01.2023.

- Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

- Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.



QAZIM (REXHË) ZYMBERI

(06.05.1945 - 01.12.2021)

Babë, qenka vështirë të shkruajmë në njëvjetorin e ikjes tënde në amshim. Qenka, njëkohësisht, krenari e madhe që kemi çfarë të shkruajmë për ty. Veprat dhe bujari që na le ne pasardhësve, na frymëzojnë çdo ditë.

Babë, po na mungon gjithsecilit, sidomos mbesave e nipave të cilat i doje shumë e u dhuroje dashuri deri në çastet e fundit të jetës. Ashtu si ne, edhe ata të përmendin orë e çast. E ndiejnë mungesën tënde të madhe fizike dhe shpirtërore. Mallin për ty përpiqen ta shuajnë nëpërmjet fotografive dhe rrëfimeve të dëgjuara prej teje.

Shpirtbardhi ynë, do të kujtojmë me krenari dhe do të përpiqemi ta ndjekim rrugën e drejtë e të hallallit që na mësove gjatë gjithë jetës.

Me krenari të përkujtojnë: gruaja Serveti, vajza Valbona, djemtë Nexhmedini, Dukagjini, Blerimi, Mërgimi, Florimi, Vetoni, rejat, nipat, mbesat dhe mbarë familja Zymeri nga Ruhoti i Pejës.

